



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKANDËR MOISIU” Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 539 / 3 Prot.

Durrës, më 10.02.2025

VENDIM

Nr. 8, datë 10.02.2025

PËR

“MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR, PROGRAMET E STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL 2-VJEÇAR, PROGRAM I INTEGRUAR I STUDIMEVE, CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE MASTER I SHKENCAVE DHE MASTER PROFESIONAL, PËR VITIN AKADEMIK 2026 – 2027, DHE KRITERET PËR PROGRAMET E REJA QË DO TË OFROHEN NË VITIN AKADEMIK 2025-2026, NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR MOISIU”, Durrës”.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 64, VKM Nr. 407 datë 01.06.2016 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në Institucionet e Arsimit të Lartë”, Vendimin Nr. 436, datë 03.06.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021–2022 e në vijim”, i ndryshuar, si dhe në shkresën e Drejtorisë së Kurrikulave Cilësisë dhe Statistikave me Nr. 461 Prot, datë 04.02.2025, në mbledhjen e datës 10.02.2025, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve të pranimin të studentëve për ciklin e parë të studimeve bachelor, programet e studimit me karakter profesional 2-vjeçar, program i integruar i studimeve, ciklin e dytë të studimeve master i shkencave dhe master profesional, për vitin akademik 2026 – 2027, dhe kriteret për programet e reja që do të ofrohen në vitin akademik 2025-2026, në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët,
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore,

➤ Drejtoria e Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

